

*“Duhet të arrijmë me besu si Zoja e Bekuar
për të dashur sikurse na do Ajo”*

D.V.



Kisha dhe Jeta

ORGAN I PËRMUAJSHËM INFORMACIONI I METROPOLISË TIRANË-DURRËS Nr. 10 DHJETOR 2016 Çmimi 30 lekë

...dhe fjala u bë njeri
e banoi ndër ne

GËZUAR
KRISHTLINDJEN



Në errësirë nuk mund të njohim atë që është afër nesh.

Është drita që na mundëson të shohim e të dallojmë fytyrat e njerëzve.

faqe 3-4

Dita e Krishtlindjes 2016

faqe 5-6

U duk hiri i Zotit,
që i sjell shëlbimin
gjithë njerëzve

Homelia e Papës Françesku
Natën e Krishtlindjes

faqe 7

Letra e Papës Assadit.
Zenari: shpresojmë në një
rrugëzgjdhje

Nunci Zenari i dorëzon
letrën e Papës Assad-it

faqe 8

Françesku: shpresa është
virtyt i të vegjëlve, të
mëdhenjtë nuk e njohin

Papa në audiencën e përgjithshme

faqe 8

Fjalët e Papës Françesku
për Shën Nënë Terezën

faqe 9

Nuk due me folë për
tolerancë, por për vllaznim,
që asht shumë ma tepër

Fjala e Kardinal Ernest Trashani Simoni,
e mbajtur ne parlamentin Shqiptar

faqe 10

Katedralja e Kajros “zgjohet”
prej zjarrit të armëve

faqe 10

Bijave të Marisë Ndhimëtare
25 vjet në Tiranë

8 dhjetor 1991-2016

faqe 11-12

Kalendari Liturgjik

Janar 2017

Vizita e Dijetarëve

Mateu 2, 1-12



Pasi Jezusi leu në Betlehemin e Judesë, në kohën e mbretit Herod, kur qe, prej Lindjes ia behën në Jerusalem disa Dijetarë, e pyetën: “Ku është foshnja e lindur, që do të bëhet mbreti i judenjve. Sepse e pamë yllin e tij duke lindur dhe erdhëm t’i shprehim nderimet tona.”

Mbreti Herod, posa i dëgjoi këto fjalë, u shqetësua vetë e me të edhe mbarë Jerusalemi. I bashkoi të gjithë kryepriiftërinjtë e skribët e popullit dhe i pyeti ku duhet të lindë Mesia. Ata i përgjigjën: “Në Betlehemin e Judesë, sepse kështu ka shkruar profeti:

“E ti, o Betlehem tokë e Judës,
ti nuk je kurrsesi më i parëndësishmi
ndër qytetet princore të Judës,
sepse prej teje do të dalë prijësi,
që do ta udhëheqë popullin tim, Izraelin.”

Atëherë Herodi i thirri fshehtazi Dijetarët dhe me kujdes mori hetime prej sish rreth kohës kur u ishte dukur ylli. Pastaj i dërgoi në Betlehem duke u thënë: “Shkoni dhe bëni me kujdes kërkime rreth fëmijës. Kur ta gjeni, më lajmëroni që edhe vetë të vij e t’i shpreh nderimet e mia.”

Ata, si e dëgjuan mbretin, u nisën. Dhe ja, ylli që kishin parë në lindjen e tij, u shkonte përpara derisa s’zuri vend aty ku ishte fëmija. Ata, kur e panë yllin, u bënë shend e verë. E, si hynë në shtëpi, panë fëmijën me Marinë, t’ëmën e tij, ranë përmbys dhe i shprehën nderimet e tyre. Pastaj hapën thesaret e veta e i dhuruan: ar, kem e mirrnë. Të mësuar në ëndërr prej Hyjit të mos ktheheshin te Herodi, u kthyen një rrugë tjetër në vendin e vet.

1 janar – E diel. Virgjëra Mari, Hyjindëse

2 janar – Sh. Bazili dhe Sh. Gregori Naziancen, ipeshkvinj e mësues të Kishës

3 Janar - Emri Tejet i Shenjtë i Jezusit

6 janar – Dëftimi i Zotit

8 janar – E diel Pagëzimi i Zotit

13 janar – Sh. Hilari, ipeshkëv e mësues i Kishës

15 janar - E DIELA II GJATE VITI (A)

16 janar – Sh. Donati, martir

17 janar – E DJELA E DYT Ë GJATË VITIT

Sh. Antoni, abat

20 janar – Sh. Fabiani, papë e martir dhe Sh. Sebastiani, martir

21 janar – Sh. Anjeza, virgjër e martire

22 janar – E DIELA III GJATE VITI (A)

24 janar – Sh. Françesku i Sales, ipeshkëv e mësues i Kishës

25 janar – KTHIM I SH. PALIT APOSTULL Feste

26 janar – Sh. Timoteu dhe Titi, ipeshkvinj

27 janar – Sh. Anxhela Meriçi, virgjër

28 janar – Sh. Toma i Akuinit, meshtar e mësues i Kishës

29 janar - E DJELA IV GJAT Ë VITIT

31 janar – Sh. Gjon Bosko, meshtar



Drejtor i përgjithshëm:

Imzot George Frenco

Kryeredaktor:

D. Marjan Lumçi

Sekretar:

Ferdinand Ndocaj

Redaksia:

Kolec Çefa
Ana Stakaj
Zef Skanjeti
Elidon Dodaj

Grafika:

Pjerin Sheldija

Foto: Pici

Adresa:

Katedralja e Shën Palit,

Bulevardi Zhan D’Ark,

Tiranë, Shqipëri

E-mail: kisha.jeta@gmail.com

www.kishadhejeta.com

Në errësirë nuk mund të njohim atë që është afër nesh.

Është drita që na mundëson të shohim e të dallojmë fytyrat e njerëzve.



Predikimi i Sh.T. Imzot George Frendo në Meshën e Krishtlindjes në Katedralen e shën Palit në Tiranë.

Të dashur besimtarë, vëllezër e motra, është mirë që e keni sfiduar ftohtin e kësaj nate për të marrë pjesë në gëzimin e këtij kremtimi. Sepse kjo natë është një natë e veçantë. Zakonisht natën e shoqërojmë me errësirë dhe heshtje. Nata është ora e frikës: vrasjet e vjedhjet kryhen më shumë natën sesa ditën.

Duke ardhur këtu keni kaluar nëpër rrugë të ndriçuara me drita shumë të bukura. Por këtu kemi një dritë që vjen prej qiellit, për të cilën profeti Isai tha: “Populli që ecte në errësirë pa një dritë të madhe”. Duke ardhur këtu keni kaluar nëpër rrugë të heshtura, ose ndoshta keni dëgjuar një zhurmë nga ndonjë diskotekë. Por këtu dëgjojmë një zhurmë tjetër: është dënesja e një fëmije të sapolindur, ose këngët e engjëjve që zbritën nga qielli për të shpallur dhe shprehur gëzimin e një ngjarjeje krejt të jashtëzakonshme. Shumë njerëz kanë frikë të kalojnë nëpër rrugë natën. Por kjo është një natë që largon çdo frikë. Para nëntë muajsh një engjëll iu paraqit Zojës Mari për ta njoftuar se do të bëhej nëna e kësaj foshnjeje që ka lindur tani. I tha: “Mos ki frikë, Mari”. Pak ditë më pas i njëjti engjëll foli me Jozefin, burrin e Marisë. I tha: “Mos ki frikë, Zef, të marrësh Marinë për gruan tënde”. Por sot është një grup i varfër njerëzish, janë barinj të Betlehemit, që dëgjojnë ato fjalë: “Mos kini frikë! Ka lindur për ju shpëtimtari”.

Dhe ju, të dashur besimtarë, keni ardhur

këtu sepse keni vendosur të shihni këtë dritë, ta dëgjoni dënesën e kësaj foshnjeje të sapolindur, dhe të merrni pjesë në atë gëzim që largon çdo frikë. Ejani të shmangim errësirën e një bote që vret shumë njerëz, që vjedh dinjitetin e të drejtat e shumë personave, ndërsa do të ndriçohemi nga kjo foshnjë që na rikthen dinjitetin tonë të pazëvendësueshëm. Ejani të shuajmë zhurmën e televizoreve ose celularëve tanë, që të dëgjojmë dënesën e kësaj foshnjeje dhe këngët e engjëjve, që tingëllojnë një muzikë që nuk ke dëgjuar kurrë më parë. Edhe vetë dënesja e asaj foshnjeje është muzikë, që bën të vallëzojnë engjëjt në qiell dhe të kërcëjnë njerëzit mbi tokë. Ejani të gjithë ju, që jeni të ftuar të merrni pjesë në atë gëzim që asgjëson çdo frikë, sepse ky është një gëzim i vërtetë, nuk është produkt i gjërave artificiale. Shumë njerëz sot harxhojnë shumë lekë në joga ose për të blerë drogë, këtu kemi një gëzim që na ofrohet falas. Nuk mashtron, nuk zhgënjën.

Por e gjithë kjo na garantohet me një kusht: që të zhvishemi nga krenaria jonë, nga egoizmi ynë, dhe të fillojmë ecjen tonë drejt asaj shpelle ku do të shohim një foshnjë që rrezaton atë dritë që na aftëson të shohim bukuritë që na rrethojnë, bukurinë e diellit dhe të detit, bukurinë e ylberit dhe të lules, por edhe bukurinë e shumë njerëzve që angazhohen për një shoqëri më të denjë për njeriun. Do të shohim një foshnjë që di ta bashkojë dënesën e vet me një buzëqeshje, me të cilën flet me ne me një gjuhë të veçantë, që është gjuha e dashurisë; sepse buzëqeshja e tij na tregon se ai na ka për zemër, duke pritur përgjigjen tonë në të njëjtën gjuhë të dashurisë. Do të përjetojmë atë gëzim që një filozof ateist,

Friedrich Nietzsche, pretendonte ta shihte tek fytyrat e të krishterëve.

Dietrich Bonhoeffer ishte një teolog i famshëm protestant, i cili, në moshë 39 vjeçe, u vra në një kamp përqendrimi nga Nazistët. Natën e Krishtlindjes e vitit 1943, nga vendi ku ishte burgosur, ka shkruar: “Ka errësirë në mua, ndërsa në ty ka dritë. Jam vetëm, por Ti nuk më braktis. Nuk kam kurajë, por ti më ndihmon; jam i paqetë, por në ty ka paqe. Në mua ka hidhërim, në ty ka durim. Nuk i kuptoj rrugët e tua, por Ti e di cila është rruga ime”.

Edhe ne, si Bonhoeffer, nganjëherë apo shpeshherë ndihemi në errësirë, të vetmuar, të shkurajuar, të paqetë, të hidhëruar. Pikërisht për këtë arsye sot duhet të kemi guxim të mësojmë jo në një universitet, por në një shpellë të varfër; jo nga një profesor i famshëm, por nga një foshnje e brishtë. Do të shohim dritë në errësirë, do të dëgjojmë dënesën e një bebi, do të fitojmë mbi çdo frikë.

Në errësirë nuk mund të njohim atë që është afër nesh. Është drita që na mundëson të shohim e të dallojmë fytyrat e njerëzve. Dhe drita e kësaj nate na mundëson të shohim jo vetëm njerëzit, por edhe vetë Zotin. Madje na ndriçon që të shohim Zotin në fytyrën e çdo njeriu. Ata që sot, pa mëshirë, po vrasin njerëz vetëm sepse nuk ndajnë me ta të njëjtën besim janë të verbër, që nuk mund të shohim fytyrën e Zotit në personin e viktimës së tyre. Mund të jetë Is-is që krenohet me brutalitetin e vet. Mund të jenë ata që kanë përdorur avionët për të shembur kullat binjake në New York, ose kanë përdorur kamionët për të shtypur njerëz që po festonin në Francë dhe në Gjermani.





Mund të jenë ata që në Alepo kanë lënë shumë fëmijë jetimë, dhe kanë lejuar që shumë njerëz të vdesin nga uria ose nga i ftohti. Drita e kësaj nate na nxit të lutemi për këta njerëz që parapëlqejnë të banojnë në errësirë më shumë sesa në dritë.

Në errësirë nuk mund të shohim rrugën. Dhe Jezusi, që ka thënë “Unë jam drita”, ka thënë gjithashtu “Unë jam rruga”. Nuk është një rrugë qorre. Është rruga e vërtetë që çon drejt asaj dashurie që jep jetën.

Por kjo natë na fton të heshtim, që të mund të dëgjojmë dënesën e foshnjës së sapolindur. Nata që dëgjoi këtë dënesë ishte si paralajmërim e asaj dite kur Jezusi qau para varrit të mikut të tij Lazrit, si edhe e asaj dite kur ai qau duke shikuar nga larg qytetin e Jerusalemit i cili kishte mundësi të pranonte një lajm të mirë, por i mbylli veshët që të mos ta dëgjonte atë lajm që shpallte dashuri, shpresë dhe gëzim. Por këtë natë duhet të dëgjojmë dënesën e Jezusit fëmijë, sepse kjo dënesë shpreh mjerimet e botës dhe bashkohet me dënesën e shumë nënave që në këtë moment po qajnë sepse nuk kanë asgjë t’u japim fëmijëve të tyre të uritur; ose me dënesën e shumë prindërve që rrezikojnë të nxirren jashtë nga shtëpitë e tyre sepse nuk mund të paguajnë qeranë; ose me dënesën e atij babai që sapo mori lajmin që do të pushohet nga puna. Natën e lindjes së Jezusit vetëm Maria e Jozefi kanë dëgjuar dënesën e Jezusit, por sot duhet ta dëgjojmë edhe ne. Në këtë Kishë Katedrale Papa Françesku ka qarë duke dëgjuar dëshminë e një prifti, Dom Ernest Troshanit, që sot është Kardinal, i cili po fliste për eksperiencën e tij, që ka qenë viktimë i barbarizmit të komunizmit që ka sunduar këtë vend për gati një gjysmë shekulli.

Por ndërsa Jezusi fëmijë po qan, nga qielli zbresin engjëjt. Ne duhet të dëgjojmë jo vetëm dënesën e Jezusit fëmijë, por edhe këngën e engjëjve. Kënga e tyre është një këngë që na mbush me gëzim. Është kënga: “Lavdi Hyjit në më të lartin qiell e paqe mbi tokë njerëzve që i ka për zemër”. Prandaj engjëjt sot na tregojnë se paqja nuk është utopi. Paqja është e mundshme. Pse, pra, nuk dëgjojmë përveçse për luftëra? Ku është paqja? Pse nuk jetojmë në paqe? Pse? Sepse



njeriu ende nuk ka kuptuar se paqja nuk është diçka që mund të prodhohet në një laborator. As është një recetë që formulohet në zyrat e Kombeve të Bashkuara. Paqja është fryti i atij vullneti të mirë që angazhohet për atë drejtësi që është themeli i paqes.

Së fundi, kjo natë largon frikën. Dhe kjo është një porosi që ka një domethënie të veçantë për kohën e sotme. Sepse kultura e sotme është kultura e frikës. Besoj se kurrë në tërë historinë e tij njeriu nuk ka përjetuar aq shumë frikë si sot. Në asnjë vend njeriu nuk ndihet i mbrojtur dhe i sigurt. Vepra terroriste kanë ndodhur në avionë, në tragete, në trena, në autobusë, në supermarkete, në shkolla, në kisha, në shtëpi private.

Por edhe sot na vijnë engjëjt dhe duhet të dëgjojmë këngën e tyre. Është një këngë që mbjell shpresë edhe në një zemër shumë të dëshpëruar. Kemi dëgjuar Ungjillin që foli për atë engjëll që u afrua tek barinjët dhe “lavdia e Zotit u shndriti”. Lexojmë se ata “u trembën për së tepërmi”. Por engjëlli u tha: “Mos kini frikë! Ja, unë po ju sjell një lajm të mirë! Sot ju lindi shëlbuesi”. Në fjalët e shën Palit, në Leximin e Dytë: “U duk hiri i Hyjit që u sjell shëlbimin të gjithë njerëzve”. Kjo natë na bind se nuk jemi kurrë vetëm. Ka lindur Shpëtimtari, që ka si titull: Emanuel – Zoti me ne. Le të jemi



edhe ne engjëj për ditën e sotme për shoqërinë e sotme, engjëj që sjellim shpresë dhe ndezim flakët e dashurisë.

Sotme u duk një dritë që nuk mund të fiket. Është drita që na bën të shohim dashurinë e Zotit dhe ta shohim Zotin në të tjerët. Kur dilni nga këtu do të thoni njëri tjetrit: Gëzuar Krishtlindjet! Por duhet të dini se ky urim do të thotë: Gëzofsh ti që ke Jezusin si udhëheqës në udhëtimin tënd! Gëzofsh ti që ke zbuluar thesarin e gëzimit të vërtetë. Është gëzimi që lind nga dashuria, që është e fortë. Ne besojmë në dashuri, dhe jo në urrejtje; ne besojmë në falje, dhe jo në hakmarrje. Ne besojmë në solidaritet, dhe jo në indiferencë përpara dhimbjes së të tjerëve. Le të jemi mësuesit e asaj dashurie që u hap horizonte të reja atyre që merren me drogë, me alkool, me seks, dhe atyre që po mendojnë të vetëvriten ose të hakmerren, duke u treguar se ka një rrugë tjetër për ta. Është rruga që u hap derën për një gëzim të vërtetë, pa u veshur me maska që fshehin një fytyrë të dëshpëruar.

Rroftë Jezusi që na ka mësuar të gjitha këto gjëra të bukura! Të lumtë ju që jeni treguar shumë guximtarë duke qenë të hapur të mësoni këto gjëra nga një fëmijë i brishtë! Rroftë Krishti në mesin e familjeve tuaja! Juve dhe familjeve tuaja ju uroj: Gëzuar Krishtlindjen!



Dita e Krishtlindjes 2016



Maria dhe Jozefi arritën në Betlehem pas një rrugë të gjatë, nga Nazareti. Nëpër piktura i shohim të hipur mbi një gomar. Por është më e mundshme që as gomar të mos kenë pasur. Ishin një çift shumë i varfër. Në atë kohë, të kishe një gomar ishte si të kesh sot një makinë luksoze Mercedes Benz, e sigurisht për Marinë dhe Jozefi nuk ishte e mundur të kishin këtë tekë. Pra unë besoj se e kanë bërë gjithë atë rrugë me këmbë. Ndoshta rrugës Jozefi mendonte: “Unë kam njerëz të mi në Betlehem, patjetër do të gjejmë ndonjë kushëri që do të na mirëpresë”. Por asnjëri nuk ka pasur mëshirë për atë grua, në orët e fundit e shtatzënisë së saj.

Kjo ishte situata kur ka lindur Shpëtimtari i botës, Jezusi. A ka ndryshuar gjendja e shoqërisë njerëzore sot? Kushedi sa shumë gra shtatzënë, në këtë moment, po lindin një fëmijë në Aleppo, pa pasur strehim, pa gjetur një mjek, pa pasur mundësi t’i mbrojnë nga i ftohti i këtyre ditëve, dhe i po ushqejnë me lotët që derdhen nga sytë e tyre, pasi nuk mund t’i ushqejnë me qumësht, sepse gjiri i tyre është tharë.

Historia e Krishtlindjes nuk është një ngjarje e së kaluarës. Po ndodh sot! Por edhe sot i bëhet njeriut një ftesë e çuditshme: që të ndërmarë një udhëtim, jo drejt një qyteti të famshëm, jo si

turist, jo për të shikuar një monument të bukur. Assesi. Është një ftesë për të shkuar në një fshat të varfër, për t’u bashkuar me disa persona të varfër, për të shikuar një fëmijë të varfër, por shumë të bukur, sepse është dashuria e mishëruar. Sot dëgjojmë edhe ne lajmin që engjëjt u drejtuan barinjve: “Po ju sjell një lajm të mirë, gëzim të madh për mbarë popullin. Sot në Betlehem ju lindi Shpëtimtari”. Dhe barinjtë e pranuan me gëzim këtë lajm: “Ejani të shkojmë deri në Betlehem e të shohim çka ka ndodhur, ngjarjen që na e kumtoi Zoti”.

Edhe ne kemi dëgjuar këtë lajm, po ashtu edhe ne, si barinjtë, kemi pranuar ftesën për të shkuar në Betlehem. Kemi ardhur këtu, për të marrë pjesë në gëzimin e barinjve. Nuk gjejmë këtu atë atmosferë të varfër si kanë gjetur barinjtë e Betlehemit, por ajo figurë e Jezusit që kemi para nesh na kujton se do ta shohim edhe ne, në rrugët tona, në ata që kërkojnë një copë buke për t’i ushqyer fëmijët e tyre; në atë që është diskriminuar sepse është zezak; në atë që ka nevojë për një operim, por nuk ka lekë për të paguar kirurgun; në atë djalë që u përjashtua nga shkolla, sepse është i pistë, pasi në barakën ku banon nuk ka as banjë as ujë. Ejani të shkojmë në Betlehem për t’u takuar me këta njerëz.

Por atje, përpara grazhdit ku shtrohet

fëmija Jezus, jemi të nxitur të mësojmë nga kjo foshnjë. Është e mundshme të mësojmë nga kjo foshnjë, por me një kusht: që të zhvishemi nga krenaria jonë. Atëherë do të jetë e mundshme të mësojmë nga ai. Së pari, duke mësuar kush është ai. Në një nga këngët që këndojmë në këtë kohë ne themi: “Ti ulesh prej parrizit – o Zot e Mbret lumnie”. Ai që është krijuesi i gjithë hapësirës, zbriti mbi tokë për ta pajtuar tokën me qiellin. E tani e shohim në këtë formë: nga pikëpamja fizike, nuk dallohet nga asnjë foshnjë tjetër. Një foshnjë e dobët, krejt i varur nga të tjerët. Kush do të besojë se është Hyji Shpëtimtar? Kush do ta pranojë se është ai që u parakallëzua nga profetët? Kush do ta pranojë? Jo Herodi, jo kryepriiftërinjtë, por njerëz të thjesht: barinjtë.

Ai erdhi për të na zbuluar fytyrën e Atij që ka si emër “Dashuri”. Dy botë, hyjnore dhe njerëzore, u përplasen në Krishtin, jo për t’u shpërthyer, por për t’u përfaquar. Krishtlindja e parë ka ndërtuar një urë të madhe mes qiellit dhe tokës.

Por kjo urë është ndërtuar mbi një shumicë të madhe urash që bashkojnë njerëzit me njëri-tjetrin. Dhe në qoftë se ti shemb një urë që të bashkon me tjetrin, atëherë nuk mund të kalosh tek ura që mund të të çojë drejt qiellit.





Jezusi erdhi për të shkatërruar muret që ndanin njerëzit nga njëri-tjetri, duke na kujtuar se duhet të ndërtojmë jo mure, por ura. Çdo vit ne kremtojmë Krishtlindje, dhe në çdo Krishtlindje që kremtojmë Krishti na kujton se duhet të shkatërrojmë muret që kemi ndërtuar ne, me paragjykimet tona, me ambiciet tona, me mendjemadhësitë tona. Ti, që deri në atë moment kur ke hyrë në këtë kishë, ke mbajtur inat dikujt, a je i gatshëm ta afrosh, t'i japësh dorën dhe t'i urosh: "Gëzuar Krishtlindje"? Nëse jo, atëherë je shtiracak, hipokrit, zemërgurë, mendjemadh. Nuk je i denjë të kremtosh Krishtlindje.

Jezusi sot ka hyrë në histori. Në një histori konkrete. Ka ditën e lindjes së vet, ka familjen e vet, ka qytetërim hebre. Më vonë ai ka qarë për Jerusalem, sepse dëshira e tij ishte të shihet një Jerusalem më të drejtë, më në paqe, më të lumtur. I krishteri i vërtetë e do sinqerisht atdheun e vet. Citoj një shkrimtar të famshëm shqiptar, një prift françeskan. Është Atë Gjergj Fishta, i cili ka shkruar: "Dersa t'mundem me ligj'rue – E sa gjallë me frymë un jam – Kurr Shqipni s'kam me t'harrue – Edhe n'vorr me t'përmendë kam". Janë fjalë të një prifti katolik, françeskan, që dinte mirë si duhet ta duam atdheun. Në shumë mënyra Shqipëria ka qenë bekuar nga Zoti. Bukuria natyrore e këtij vendi, njerëz fisnik që kanë pasuruar historinë e vendit, shpirti mikpritës që, në një botë e cila po bëhet përditë më anonime, ende karakterizon këtë popull, harmonia që ekziston mes besimeve të ndryshme të pranishëm në këtë vend: ja disa prej gjërave për të cilat duhet të ndihemi krenarë që banojmë në këtë vend. Por Jezusi sot na tregon si mund ta tregojmë dashurinë tonë për Shqipërinë në mënyrë që kjo të bëhet vend më i denjë për Shqiptarët.

Asnjëri nuk ka të drejtë të thotë: "Kjo nuk është puna ime". Po, është puna jote, është puna ime, sepse te gjithë jemi qeliza të gjalla të shoqërisë. Dhe secili prej nesh gjendet para një alternative: ose të mbjellë urrejtje, ose ta mbjellë dashuri. Krishti, Kisha, si edhe dashuria jonë për atdheun na nxisin të jemi mbjellës dashurie, për një shoqëri ku nuk do të ekzistojë më vrasja, sepse respektojmë fytyrën e Krishtit që pasqyron në fytyrën e çdo njeriu; nuk do të ekzistojë as vetëvrasja, sepse ai person me depresion është i bindur se është i rrethuar nga njerëz që e kuptojnë dhe e duan; nuk do të ekzistojë më droga

ose alkoholizmi ose abuzime seksuale, sepse dashuria do të bëhet burimi i gëzimit të vërtetë pa pasur nevojë të përdorim mjete artificiale për ta shmangur problemet e jetës së përditshme. Kjo është shoqëria që duam të ndërtojmë, ja mënyra se si duhet të tregojmë dashurinë tonë për atdheun.

Një shkrimtar amerikan ka krahasuar situatën e botës së sotme me situatën e një grupi udhëtarësh mbi një avion, të cilët në një moment gjatë udhëtimit vërejnë se në avion nuk ka pilot. Krijohet panik i madh. Nuk dinë kah shkojnë, si do të përfundojnë.

Në jetën tonë kemi nevojë për një pilot. Jezusi është piloti ynë. Me një pilot të tillë nuk do të kemi asnjë frikë. Jemi në duar të sigurta. Ai do të na çojë në tokën e dashurisë, sepse Ai vetë është dashuria e mishëruar. Me Jezusin si pilot do të ndihemi të sigurtë.

Sot mbi tokë u duk një dritë që nuk mund të fiket. Është drita që na bën të shohim dashurinë e Zotit dhe ta shohim Zotin në të tjerët. Është Jezusi fëmijë.

Shikojeni në grazhd. Është me duar të hapura. Zakonisht jemi ne që, kur e shohim një bebe, i hapim duart drejt atij për t'i thënë: Eja tek unë! Por sot nuk jemi ne që i hapim duart Jezusit e t'i themi: Eja tek unë! Jo. Është ai që na thotë "Eja tek unë", duke hapur duart e tij. Ende nuk flet, dhe vetëm me gjeste na thotë

këto fjalë. Por do të rritet, e kur të rritet do të thotë me gojën e tij ato fjalë: "Ejani tek unë, të gjithë ju që jeni të lodhur prej barrës së rëndë, e unë do t'ju çlodh". Ejani tek unë, ju që merreni me drogë ose me alkool, ju që po planifikoni si të hakmerrni ndaj armikut, ju që në momente depresive mendoni si t'i jepni fund jetës suaj.

Vëllezër e motra, në këtë ditë le t'u japim dorën atyre të cilëve ua kemi refuzuar deri tani. Le t'u buzëqeshim atyre para të cilëve jemi paraqitur gjithmonë me fytyrëgjatë. Dhe mos të harrojmë se nuk kemi të drejtë ta mbajmë gëzimin tonë vetëm për veten tonë. Zoja Mari ka ndjerë nevojën ta ndajë gëzimin e vet me Elizabetën. Shën Pali nga burgu ka ndarë gëzimin e vet me Filipianët. Shën Nënë Tereza vazhdimisht u thoshte motrave: "Jepni një buzëqeshje të madhe". Sepse një buzëqeshje është gjithmonë shenjë që ti e pranon atë person dhe po ndan gëzimin tënd me të. Një buzëqeshje do të thotë të shohësh të tjerët me sytë e Hyjit.

Shpirti Shenjt na ndriçoftë që të zbulojmë thesaret e gëzimit të krishterë dhe të zbulojmë rrugët si ta përçojmë këtë gëzim!

Rroftë Krishti, burimi i gëzimit tonë! Rroftë Krishti, që nga grazhdi, me buzë në gaz, na zbulon dashurinë e tij për secilin prej nesh! Është për këtë arsye dhe me këtë shpirt që unë sot mund t'ju uroj, juve dhe familjeve tuaja: Gëzuar Krishtlindje!



U duk hiri i Zotit, që i sjell shëlbimin gjithë njerëzve

Homelia e Papës Françesku Natën e Krishtlindjes

“U duk hiri i Zotit, që i sjell shëlbimin gjithë njerëzve” (*Tt 2,11*). Fjalët e Shën Palit Apostull zbulojnë misterin e kësaj nate të shenjtë: u duk hiri i Hyjit, dhurata, që nuk pret shpërblim: në Fëmijën, që na u dhurua, bëhet konkrete dashuria e Zotit për ne.

Është nata e lumnisë, asaj lumnie, që u shpall nga Engjëjt në Betlehem e edhe nga ne, në mbarë botën. Natë gëzimi, sepse që sot e përgjithmonë, Hyji, i Amshuari, është Zoti me ne, nuk është i largët, nuk duhet ta kërkojmë në orbitat qiellore a në ndonjë ide mistike; është pranë, u bë njeri e nuk do të lodhet kurrë nga natyra jonë njerëzore, të cilën e bëri të vetën. Është natë drite. Drita e profetizuar nga Isaia (*krh 9,11*), që do ta ndriçonte kë ecte në tokën e hijes së vdekjes, u duk e i mbështolli barinjtë e Betlehemit. (*krh Lk 2,9*).

Barinjtë zbulojnë vetëm se “një fëmijë lindi për ne” (*Is 9,5*), dhe kuptojnë se e gjithë kjo lumi, i gjithë ky gëzim, e gjithë kjo dritë, ishte përqendruar në një pikë të vetme, në atë shenjë, që u kishte treguar engjëjlli: “Do të gjeni një fëmijë të mbështjellë në fasha, të vënë mbi një grazhd” (*Lk 2,12*). E kjo është gjithnjë shenja për ta gjetur Jezusin. Jo vetëm atëhere, por edhe sot. Nëse duam të kremtojmë një Krishtlindje të vërtetë, ta kundrojmë këtë shenjë: thjeshtësinë e brishtë të një të posalinduri, njomësinë e tij mbi kashtë, butësinë e ëmbël të fashave, që e mbështjellin. Aty është Zoti.

Me këtë shenjë Ungjilli na zbulon një paradoks; flet për një perandor, një guvernator, për të mëdhenjtë e asaj kohe, por Zoti nuk është i pranishëm në ta, nuk duket në sallën e fisme të një pallati mbretëror, por në varfërinë e një stalle; nuk është ndër analet e dukjes, por në thjeshtësinë e jetës, nuk është në pushtet, por në vogëlsi, që të mahnit. E, për ta takuar, duhet të shkosh atje ku është, duhet të përkulesh, të ulesh, të bëhesh i vogël. Fëmija që lind, na flet, na kërkon mendimin tonë, nësa bën thirrje t’i braktisim iluzionet e kalimtares, për të shkuar tek themeloria, për të hequr dorë nga pretekstet tona të pangishme, për ta braktisur pakënaqësinë dhe trishtimin për gjithçka që na mungon. Na bën mirë t’i lëmë mënjane këto gjëra, për të rigjetur thjeshtësinë e Zotit-Foshnjë, paqen, gëzimin, kuptimin e ndritshëm të jetës.

Ta lëmë Foshnjën e grazhdit të na flasë nga kashta, por t’i lëmë të na flasin edhe fëmijët, që sot nuk tunden në djep, as nuk ledhatohen me dashuri nga nëna a nga babai, sepse dergjen në “grazhdet e dinjitetit” të



nëpërkëmbur, në strehimet e nëndheshme, për të shpëtuar nga bombardimet, në trotualet e qyteteve të mëdha, në fundet e barkave të mbingarkuara ne emigrantë. T’i lëmë të na flasin fëmijët, që nuk lejohen as të dalin në dritë, ata që qajnë, sepse askush nuk ua shuan urinë, ata që nuk kanë në duar lojëra, por armë!

Misteri i Krishtlindjes, që është dritë e gëzim, flet e trand, sepse është mister shprese e edhe trishtimi. Sjell me vete shijen e trishtimit, sepse dashuria nuk mirëpritet, jeta shikohet si hedhurinë. Kështu u ndodhi Jozefit e Marisë, që i gjetën portat e mbyllura dhe e vunë Jezusin në një grazhd, “mbasi për ta nuk kishte vend në bujtinë” (*v 7*). Jezusi lindi i papranuar nga disa e i rrethuar nga indiferenca e shumicës. Edhe sot mund ta vërejmë të njëjtën indiferencë, kur Krishtlindja bëhet festë, në të cilën protagonistë jemi ne, në vend që të ishte Ai; kur dritat e tregtisë e flakin në errësirë dritën e Zotit; kur shqetësohemi për dhuratat e mbetemi fare të pandjeshëm përballë njeriut të lënë krejtësisht pas dore. Kjo mendësi e botës na e mori peng Krishtlindjen, duhet ta lirojmë!

Por Krishtlindja ka posaçërisht shijen e shpresës, sepse, pavarësisht nga terrinat tona, drita e Zotit shkëlqen. Drita e tij e fisme nuk të ngjall frikë; Zoti, i dashuruar me ne, na tërheq me njomësinë e vet, duke lindur i varfër e i brishtë mes nesh, si njëri nga ne. Lind në Betlehem, që do të thotë “shtëpia e bukës”. Duket, kështu, sikur dëshiron të na thotë se po lind si bukë për ne: se vjen

në jetë, për të na dhënë jetën e Tij; vjen në botën tonë, për të na sjellë dashurinë e Tij. Nuk vjen të përlejë, as të komandojë, por të ushqejë e të shërbejë. Kështu është një fill i drejtpërdrejt, që lidh grazhdin me kryqin, ku Jezusi do të jetë bukë e thyer; është filli, i cili e lidh drejtpërdrejt dashurinë, që dhurohet me atë, që shëlbbon, që i jep dritë jetës sonë e paqe zemrave tona.

Këtë e kuptuan mirëfilli barinjtë, të mënjanoarit e asaj kohe. Po në sytë e Zotit nuk mënjanohet askush, e prandaj qenë pikërisht ata, të ftuarit e Krishtlindjes. Kush ishte i sigurt në vetvete, kush ishte plot me vetveten, ishte në shtëpi, ndërmjet rraqeve të veta; ndërsa “barinjtë shkuan me nxitim” (*Krh Lk 2,16*). Ta lëmë edhe ne Jezusin të na flasë këtë natë, të shkojmë tek Ai me besim, duke u nisur nga kufizimet tona, duke u nisur nga mëkatet tona. Ta lëmë të na prekë me njomësinë, që shpëton. T’i afrohemi Zotit, që bëhet i afërt, të ndalemi e ta kundrojmë Shpellën e Betlehemit, ta përfytyrojmë lindjen e Jezusit: dritën e paqen, kulmin e varfërisë e të mospranimi. Të hyjmë në Krishtlindjen e vërtetë bashkë me barinjtë, t’i çojmë Jezusit gjithë çka jemi, mënjanimet tona, plagët tona të pambyllura, mëkatet tona. Kështu, në Jezusin, do të shijojmë shpirtin e vërtetë të Krishtlindjes: ta provojmë sa bukur është të ndjesh se të do vetë Zoti. Me Marinë e Jozefin të rrimë para grazhdit, para Jezusit, që lind si bukë për jetën tonë, timen. Ta kundrojmë dashurinë e Tij të përvujtë e të pafundme, t’i themi thjesht faleminderit; faleminderit që e bëre gjithë këtë për mua!

Letra e Papës Assadit. Zenari: shpresojmë në një rrugëzgjidhje

Nunci Zenari i dorëzon letrën e Papës Assad-it

Gjithnjë më i ndërlikuar skenari në Siri. Lufta vijon pa fund. E zëri i Papës dëgjohej përsëri, pas thirrjes të së dielës në lutjen e Engjëllit të Tënzot. Françesku kërkon ndalimin e dhunës dhe respektimin e së drejtës humanitare ndërkombëtare. E bën këtë përmes një letre drejtuar presidentit sirian Assad, dorëzuar nga Nunci apostolik, kardinali Mario Zenari. Ndërkaq Halebi vijon të jetojë nën breshërinë e bombave të forcave qeveritare, ndërsa Palmira mbetet e rrethuar nga Shteti Islamik.

Papa, pra, ia besoi Nuncit apostolik, kardinalit Zenari, lartësuar në rangun e kardinalit pikërisht në shenjë afërsie me popullin e dashur sirian, letrën për presidentin. Në tekst, siç njofton Salla vatikanase e Shtypit, lexohet thirrja drejtuar Bashar al Assad-it dhe bashkësisë ndërkombëtare "për t'i dhënë fund dhunës" e për rrugëzgjidhjen paqësore të konfliktit. Në letër dënohen edhe të gjitha format e ekstremizmit e të terrorizmit, nga çdo anë që të vijnë, ndërsa presidenti nxitet të sigurojë respektimin e plotë të së drejtës humanitare ndërkombëtare, duke vënë në plan të parë mbrojtjen e civilëve dhe hyrjen e ndihmave humanitare. Nunci Apostolik, kardinali Zenari, lidhur me dorëzimin e letrës papnore presidenti Assad, gjatë një bisede sjelljeje informon:

Përgjigje: -U prita sot në mëngjes nga presidenti. Ishte vizitë mirësjelljeje. I ktheja, kështu, vizitën qeverisë, që dërgoi një delegacion, duke pasur parasysh se shkova në Romë ipeshkëv e u ktheva kardinal. E kjo ishte një ngjarje e pashembullt, gjë që e kuptuan të gjithë - nga qeveria, tek qytetarët - se ishte një gjest nga ana e



Papës, për t'i shprehur afërsinë e tij sirianëve. Me rastin e kësaj vizite, e në klimën e këtij emërimi, ia dorëzova letrën e Papës. Nuk është e vështirë të merret me mend çka shkruhet në këtë letër. Në të përmbledhet gjithçka, që Papa e ka thënë vazhdimisht lidhur me konfliktin sirian. Aspekti humanitar, in primis.

Pyetje: -Ju patët përshtypjen se presidenti po e merrte me angazhim letrën papnore?

Përgjigje: -Përshtypja që pata është se e mori këtë letër të Papës - do të thosha - me shumë mirënjohje. E lexoi dhe e vlerësoi, këtë mund të them...

Pyetje: -Është, sigurisht, një hap i madh dhe i rëndësishëm e, duke pasur parasysh edhe çastin kaq delikat për Sirinë, ndoshta kjo mund të ndikojë për të ngjallur shpresa të reja...

Përgjigje: -Këtë e dëshirojmë të gjithë: që të hapet ndonjë spirale, të ketë ndonjë gjë të re për zgjidhjen e konfliktit, me vetëdijen se kjo

nuk është e lehtë! Duhet vijuar në rrugën, që synon t'i japë fund dhunës, rrugën e hyrjes së ndihmave humanitare e të pajtimit, posaçërisht në këto çaste, në Haleb, ku çmimin më të lartë të këtij konflikti po e paguan popullsia civile. Si besimtarë e si të krishterë, lutemi...

Thirrja e Papës arrin kur Halebi është 96% në duart e lealistëve, të mbështetur nga rusët e nga Irani. Rebelët e lagjeve lindore, pas evakuimit të qindra mijëra civilëve brenda një muaji, mbeten në më pak se 8 km². Shifrat janë të mbrojtjes ruse, që flet edhe për situatën në Palmirë. Atje Is ka arritur në periferinë e qytetit, duke hapur rrugën edhe me autobomba. Sulm, ky, që Moska ia atribuon ndalimit të luftimeve të forcave amerikane në Raqqa dhe armëpushimeve të panumërta në Haleb, të cilat ndikuan për përforsimin e milicive xihadiste, në radhët e të cilave po përfshihen edhe luftëtarët në ikje nga Iraku.

Françesku: shpresa është virtyt i të vegjëlve, të mëdhenjtë nuk e njohin

Papa në audiencën e përgjithshme

"Shpresa e krishterë nuk të zhgënjën kurrë". Këtë nënvizoi paraditen e 7 dhjetorit Papa në audiencën e përgjithshme, duke iu drejtuar besimtarëve, mbledhur nga mbarë bota në Sallën e Palit VI, në Vatikan. Turmë medituese, por edhe gazmore, në përkim të dukshëm me Kohën e Ardhjes, kur pritet që ngjarja e madhe të ngjallë shpresa të reja edhe në zemrat më të përhumbura. Gjatë audiencës, Françesku bëri dy thirrje: për të luftuar kundër korrupsionit dhe për të mbrojtur të drejtat e njeriut, në prag të Ditëve ndërkombëtare, më 9 e më 10



dhjetor, kushtuar këtyre temave.

E sot Papa nisi katekizmin e parë të një serie të re, kushtuar shpresës së krishterë:

“Është shumë e rëndësishme, sepse shpresa nuk të zhgënjën. Optimizmi të zhgënjën, shpresa, jo! Qartë?”.

Kemi shumë nevojë për të, nënvizoi Papa:

“... në këto kohë, që duken të errëta, në të cilat nganjëherë ndjehemi të përhumbur përballë së keqes e dhunës, që na rrethojnë e përballë dhimbjeve tona e të vëllezëve tanë. Duhet shpresuar!”.

Duhet, sepse ndjehemi jo vetëm të përhumbur, por edhe të shkurajuar:

“...ngaqë ndjehemi krejtësisht të pafuqishëm e na duket sikur kjo errësirë nuk do të davaritet kurrë”.

Por nuk duhet të mendojmë se do të na braktisë edhe shpresa, përkundrazi, nuk duhet harruar se ...

“... Zoti, me dashurinë e Tij, ecën me ne! Unë shpresoj, sepse Zoti është pranë meje”.

Shpresë, pra, që vështirësitë të mos na lënë edhe pa aftësinë për ta vënë buzën në

gaz:

“Një nga gjërat, një nga gjërat e para, që u ndodh njerëzve, të cilët shkëputen nga Zoti, është se janë njerëz pa buzëqeshje; ndoshta janë në gjendje të shkrihen në gaz, të qeshin papushuar, të thonë batuta e të qeshin e të qeshin...”.

Por gazi i vërtetë, ai që del nga zemra, u mungon:

“Buzëqeshjen e vërtetë na e jep vetëm shpresa. E kuptuat këtë? Është buzagazi, që buron nga shpresa se do ta gjejmë Zotin”.

Jeta shpesh herë shndërrohet në shkretëtirë, ku është vështirë të ecësh, vërejtji Françesku:

“... por, nëse ia besojmë Zotit, mund të bëhet e bukur, e gjerë si një autostradë, mjafton të mos e humbasim kurrë shpresën, mjafton të vijojmë të besojmë, gjithnjë, pa marrë parsasysh asgjë tjetër”.

Megjithatë, nuk mund ta mohojmë – vijoi Papa – se bota e sotme është në krizë feje:

“Po, pastaj themi: ‘Unë besoj në Zotin, jam i krishterë’ – ‘Unë i përkas kësaj feje’. Por jeta jote është shumë larg nga feja e krishterë; shumë larg nga Zoti”.

Ç’duhet bërë, atëherë? Duhet ta kërkojmë Zotin, të pendo kemi e ta kthejmë zemrën kah Zoti, ta përgatisim në këtë kohë Ardhjeje takimin me Krishtin Fëmijë, duke shikuar njerëzit e vegjël, të thjeshtë, të cilët i gjejmë përreth Jezusit, që lind:

“Janë të vegjlit, që u bënë të mëdhenj nga feja e tyre, të vegjlit, që dinë të vijojnë të shpresojnë. E shpresa është virtyt i të vegjëlve. Të mëdhenjtë, të kënaqurit nga vetvetja nuk e njohin shpresën, nuk dinë ç’është shpresa”.

T’i lëmë, prandaj, të vegjlit të na e mësojnë shpresën:

“Ta presim me besim ardhjen e Zotit e, sido që të jetë shkretëtira e jetëve tona, e secili e di vetë në cilën shkretëtirë ecën, sido, pra, që të jetë shkretëtira e jetëve tona, do të bëhet kopsht i lulëzuar. Shpresa nuk zhgënjën!”.

Fjalët e Papës Françesku për Shën Nënë Terezën në Mesazhin e Paqes 2017

Në Mesazhin për Paqen 2017, i cili u bë i njohur më 12 dhjetor 2016, veç të tjerave Papa Françesku shkruan edhe për Nënë Terezën, duke e fokusuar si shembullin për mospërdorimin e dhunës. Në vazhden e idesë qendrore të mesazhit “Mospërdorimi i dhunës: stili i politikës për paqen” fjalët e Atit të Shenjtë kanë qenë:

“Mospërdorimi i dhunës kuptohet nganjëherë si të ishte dorëzim, mosangazhim e pasivitet, por në të vërtetë, nuk është kështu. Kur Nënë Tereza mori Çmimin Nobel për Paqen në vitin 1979, e deklaroi haptas mesazhin e saj për mospërdorimin aktiv të dhunës: ‘Në familjen tonë nuk kemi nevojë për bomba e armë, për të shkatërruar që të sjellim paqen, por vetëm për të ndenjtur së bashku, për ta dashur njëri-tjetrin... E do të kapërcenim çdo të keqe të kësaj bote’ (1). Sepse forca e armëve është mashtruese. ‘Ndërsa trafikantët e armëve bëjnë punën e tyre, ka veprimtarë të shkretë të paqes, që vetëm për të ndihmuar një njeri, një tjetër e një tjetër e një tjetër, japin jetën; për këta veprimtarë të paqes, Nënë Tereza është ‘simboli, ikona e kohëve tona’ (2). ‘Në muajin e shtatorit pata gëzimin e madh ta shpall shenjtë’ vijoi Papa: ‘Lavdërova gatishmërinë e saj ndaj të



gjithëve, përmes mikpritjes dhe mbrojtjes së jetës njerëzore, asaj të palindurës, asaj të braktisurës e të hedhurës... [Nënë Tereza] u përkul mbi njerëzit e rraskapitur, lënë vdekur rrugëve, duke u njohur dinjitetin, që Zoti u kishte dhënë; e ngriti zërin para të pushtetshmëve të botës, që t’i kuptonin fajet e tyre para krimeve – para krimeve! – të varfërisë, krijuar prej tyre” (3). Si përgjigje, misioni i saj – e në këtë përfaqëson mijëra, madje, miliona njerëz – ishte të shkonte

drejt viktimave, me bujari e përkushtim, duke prekur e fashuar çdo trup të plagosur, çdo jetë të këputur.

(1) Nënë Tereza, Fjalimi për Çmimin Nobel, 11 dhjetor 1979.

(2) Meditim, “Rruga e paqes”, Kapela e Shtëpisë së Shën Martës, 19 nëntor 2015.

(3) Homelia për kanonizimin e së Lumes Nënë Terezë të Kalkutës, 4 shtator 2016.

Nuk due me folë për tolerancë, por për vllaznim, që asht shumë ma tepër

Fjala e Kardinal Ernest Trashani Simoni,
e mbajtur ne parlamentin Shqiptar

Të nderuem Deputetë, i nderuem z. Kryetar, të nderuem Ministra, i nderuem z. Kryeminister, i nderuem trupi diplomatik, të nderuem të ftuem! Asht një nder i veçantë sot për mue me folë prej kësaj foltoreje, dhe me ju drejtue ju, përfaqësuesve të popullit shqiptar.

Ashtu siç asht një nder i pashoq me përfaqësue dhe me folë në emën të Kishës katolike shqiptare.

Nuk kam ardhë këtu me ju mësue asgjë të re, por kam ardhë ma së parit me falenderue atdheun e të gjithë popullin pse mbas një rrebeshi prej gadi pesë dekadash që i shkaktoi vyejtje e mjerime Kishës katolike, ma në fund gjeti forcën e duhun shpirtnore me ua njohtë vlerat bijve e bijave të tija që për me ruejt lirinë e ndërgjegjes dhe lirinë e besimit nuk i ranë mohit Zotit dhe nuk e braktisën popullin e tij.

Jam i fundit dëshmitar i një brezi klerikësh katolike që vyejtën dhe u persekutuen. Tue më ba kardinal, Papa Françesku nuk më nderoi veç mue, por nderoi gjithë Kishën katolike shqiptare e mundësisht gjithë popullin shqiptarë.

Ne, kemi punue me të gjitha forcat për ngritjen morale dhe kulturele të shqiptarëve, e edhe atëherë kur s'kemi pasë mjete tjera, kemi gjetë fjalë ngushëlluese dhe s'i kemi lanë vetëm ma të vogjlit dhe ma të vorfnit. I kemi shërbye këtij populli dhe kemi dëshmue me gjakun tonë se i përkasim atij dhe nuk ligshtohena edhe në orën ma të vështirë. Ky popull ka nda kashatën e gojës me ne, na ka ndihmue aq sa ka mujtë dhe na ka qindruë afër.

Të dashtun vëllezën e motra,

Po ju them se ne si Kishë katolike do të jena si gjithmonë në parimin e bashkëpunimin me gjithë ato forca politike dhe shoqnore që kanë me punue për zhvillimin dhe përparimin e Shqipnisë demokratike dhe sovranë.

Do të mbështesim gjithmonë zhvillimin e kulturës së vërtetë dhe s'do të reshtim tue punue për me i përkit familjes së përbashkët europiane, vlerat ma të kullueta të së cilës kemi kontribue edhe ne me i formue ndër shekuj.



Jam këtu me ju kujtue përvujtnisht ju, përfaqësuesve të këtij populli:

– Kujto juni orë e çast se jeni këtu me një mision të naltë, prandaj mos i harroni nevojat e popullit, mos e leni mbas doret asnjë çast popullin tuej, e mos lejoni që përplasjet tueja politike, edhe atëherë kur janë të arsyeshme, të kenë në qendër luftën për pushtet, por vetëm problemet e popullit shqiptar.

Jemi një komb ku jetojnë vllaznisht besime të ndryshme fetare, të barabarta para ligjit e të gjitha me detyrën e shenjtë me i shërbye Zotit dhe idealeve tona kombtare. Nuk due me folë për tolerancë, por për vllaznim, që asht shumë ma tepër.

Ta kultivojmë pra vllazninë ndër fetare, besimi i vërtetë në Zotin dhe liria na ndihmojnë me gjallnue ma fort vlerat e solidaritetit dhe të ndihmës ndaj gjithë atyne që shoqnia i ka lanë mënjanë.

Krishti, tue marrë shëmbëlltyrën njerzore ka lindë në një votër të vorfën prej Marisë dhe shpirtit shenjtë. Kujdesin ma të madh ai e ka pasë për të vobektit, për të sëmuret, për ata që vyejnë padrejtsisht dhe për ata që pendohen dhe duen me ndërrue rrjedhën e

jetës së tyne.

Mos t'i lamë mbas doret të gjithë këta, pse shkalla e qytetnisë së një kombi matet edhe prej kujdesit që ai tregon ndaj këtyne kategorive. Për ju un kam vetëm një porosi atnore: Krishti ka shtrë parimin hyjnorë të pavdekësisë së shpirtit: Çfarë të vlen o njeri? Po fitove edhe të gjitha pasuritë e botës në qoftëse humb shpirtin. Pra të përpiqemi ti shërbejmë me të gjitha forcat shërbimit hyjnor, që të fitojmë lumturinë e parrizit.

Po hyjmë në vitin 2017 viti i triumfit të zemrës së papërlyer të Zojës së bekuar, nanës së Krishtit që na fton të lutemi për paqen, vëllazërim, dashuri e lumturi.

Ju të nderuar deputetë të përpiqeni që të gjithë së bashku, çdo njeri në Shqipëri duke shikuar në sytë tuaj të shohë begatinë, drejtësinë, bujarinë e bekimin hyjnorë.

– Qëndroni ma afër problemeve të popullit shqiptar, bani që politika të jetë shërbim dhe jo përfitim, e vetëm atëherë keni me pasë respektin e thellë të njerëzve të thjeshtë që kanë besue tek ju.

Zoti e bekoftë Shqipninë dhe shqiptarët, Zoti i bekoftë familjet tueja!

Katedralja e Kajros “zgjohet” prej zjarrit të armëve

Një zgjim prej zjarrit të armëve – Njo ka ngjarë dje në mëngjes në lagjen Abbasiya të Kajros: shpërthimi goditi kapelën pranë Katedrales kopte të Sh. Markut, siç referon për gazetën Al-Ahram i Përnderuari Paul Halim, zëdhënës zyrtar i kishës.

Ministri i Shëndetësisë deklaroi se numri i saktë i viktimave për momentin është 25 vetë, mes të cilëve 6 fëmijë; nga atentati mbetën të plagosur edhe pesëdhjetë persona të tjerë.

Nga revoltat që në 2011 çuan në rrëzimin e regjimit të Hosni Mubarak-ut, të krishterët egjiptianë kanë pësuar sulme të shumta, me disa dhjetra të vdekur nga matricat sektare. Koptët të përfaqësuar dobësisht në qeverinë egjiptiane, përbëjnë 10 % të 91 milionë qytetarëve egjiptianë.

12 kg tritol?

Pas sulmit terrorist, qindra vetë janë bashkuar përpara katedrales në një manifestim spontan për të protestuar kundër atentatit dhe për të kërkuar heqjen e Ministrit të Brendshëm Magdy Abdel Ghaffar.



Shpërthim sipas raporteve paraprake është relatuar në përdorimin e rreth 12 kg tritol, ndonëse një oficer ka deklaruar për CNN-in se “është ende shumë shpejt për të pohuar me përpikmëri tipin dhe sasinë e eksplozivit të përdorur”.

Një video paraqet xhama të thyer dhe mbeturinat e tjera të shpërndara mbi

dyshe-menë e kishës, me disa njolla gjaku në bankat prej druri.

Askush nuk e merr përsipër

Sulmi ka pasur si objektiv Katedralen kopte të Sh. Markut, një ndër vendet më të rëndësishme fetare për koptët. Nuk ka pasur ende një marrje përsipër të atentatit që ka vrarë së paku 25 besimtarë.

Bijave të Marisë Ndihmëtare 25 vjet në Tiranë 8 dhjetor 1991-2016

Nën Mantelin e Marisë, për të thënë NFALEMINDERIT për 25 vite të pranisë të Bijave të Marisë Ndihmëtare në Tiranë, për të kujtuar ditëlindjen e Oratorit një traditë e bukur e çdo Shtëpie Saleziane, në të cilën çdo salezian/e, çdo i ri e re i jep nderime Zojës së Papërlyer.

Çdo gjë e ka bërë Maria, do thoshte Don Bosko në fund të jetës së tij, pasi çdo gjë kishte filluar me një “Të Falem Mari...”

Si Don Bosko ashtu edhe Maria Mazzarello, e bënin gjithmonë të pranishme, amnore, të fuqishme Marinë në jetën e të rinjve dhe edukatorëve. Ashtu edhe për ne, nuk mund të jetë ndryshe edhe në ditët tona, në shtëpitë Saleziane.

Me 8 dhjetor ora 12:00 e gjithë bashkësia edukative, shumë të rinj e fëmijë, u bashkuan me ne për një moment feste, bekimi dhe falenderimi. Çdo gjë nisi me një spektakël muzikor, të përgatitur nga të rinjtë e oratorit, nuk mungoi as prania e prindërve (të fëmijëve) të cilët në mënyra të ndryshme



tregojnë çdo ditë mirënjohjen e tyre ndaj Institutit dhe mbarë bashkësisë edukative.

Qe një nderë i madh prania e vëllzërve tanë Salezian, dhe prania e arqipeshkvit

tonë Mons. George Frenzo, ai duke dhënë përsipër të pranishëmve, shprehu kënaqësinë e tij kur shikon të punohet me të rinjtë, pasi ato janë e ardhmja e vendit, nëse



edukojmë të rinjtë, jemi duke ndërtuar mirë dhe me bazamente të forta.

Në këtë festë ishin të pranishëm edhe shumë miqë të Qendrës Maria Mazzarello, nxënës dhe ish-nxënës, që kanë parë këtë qendër duke u rritur dita ditës.

Bekimi i mjediseve të oratorit, qe një

moment shumë i thellë dhe i rëndësishëm për të gjithë të pranishmit, mbi të gjitha për fëmijët e oratorit që do të jetojnë në ato mjedise. Për të mbyllur këtë moment feste, motër Teuta Buka, drejtoreshë e Qendres Maria Mazzarello, falenderoi të gjithë të pranishmit për praninë dhe gëzimin që na

sjellin çdo ditë, duke bashkëndarë me ne misionin që Zoti na ka besuar!

Çdo gjë përfundon me një koktail për të gjithë të pranishmit.

Një dëshirë të vetme kam, t'ju shoh të lumtur tani e dhe në amshim! (Don Bosko)
Motrat Saleziane, Tiranë

Njeriu dhe shkëmbi

Një burrë flinte në kasollen e tij, kur papritmas një dritë e ndriçoi vendi ku flinte dhe ju duk Zoti.

Zoti i tha se kishte një punë për të duke i folur për një shkëmb i cili gjendej përballë kasolles së tij. I tregoi se duhet të shtynte gurin e madh me të gjithë forcën që kishte. Njeriu filloi të bënte ashtu sikurse Zoti i kishte kërkuar dhe ditë për ditë bënte vetëm atë gjë.

Për shumë vite, qëkur dilte dielli e derisa perëndonte, njeriu vazhdonte të shtynte atë gurë të ftoftë, por guri nuk lëvizte nga vendi as për një centimetër të vetëm.

Çdo mbrëmje, njeriu kthehej në kasollen e tij shumë i lodhur por dhe i bindur gjithnjë e më shumë se i gjithë mundi i tij ishte i kotë. Kështu dalë nga dalë filloi të dëshpërohej, dhe Djalli përfitoi nga kjo gjendje e dobët shpirtërore e njeriut dhe u fut në mendjen e njeriu duke i vënë aty brenda dyshime të forta: “Je duke gabuar gjithçka! Je duke e shtyrë atë shkëmb prej shumë kohësh, por ai as një milimetër të vetëm nuk ka lëvizur nga vendi!”

Njeriu dalë nga dalë filloi të bindet se detyra e cila i ishte besuar ishte detyrë e pamundur për tu realizuar dhe se ai vetë si njeri ishte një njeri i falimentuar.

Këto mendime e shtonin gjithnjë e më shumë dëshpërimin e tij.

Atëherë Djalli ndërhyri përsëri: “Pse duhet të sforcohesh kaq shumë gjithë ditën në këtë detyrë të pamundur? Bëj vetëm ca mundime, por të vogla dhe do të jetë mjaftueshëm sa për të thënë se diçka po



bën!”. Njeriu mendoi të vërë në praktikë këtë këshillë, pasi edhe me vete mendonte se gjithë sforcimet që kishte bërë deri më tani asgjë nuk kishin vlejtur.

Por, si fillim vendosi ti drejtonte një lutje Zotit duke i rrëfyer Atij ndjenjat e tija: “O Zot, kam punuar shumë me të gjitha forcat e mia në shërbimin tënd. Kam përdorë krejt forcën që kisha për të realizuar atë që më kishë kërkuar, por nuk kam arritur ta lëvizim shkëmbin as edhe një milimetër të vetëm. Kam punuar kot, jam një njeri i falimentuar! Është më mirë që të më japësh diçka tjetër për të bërë!”. Atëherë, Zoti ju përgjigj me shumë dhembshuri: “Biri im, kur të kërkoja që të më shërbesh dhe ti pranove, unë të thashë se detyra jote ishte që ta shtysh gurin me krejt forcën tënde dhe ti këtë gjë e bërë. Por, unë kurrë nuk të kam thënë që duhet ta lëvizësh nga vendi. Detyra e jote ishte vetëm që ta shtyje. Nuk do të duhej të shqetësoheshe për ta lëvizur nga vendi, për atë gjë do të mendoja unë më pas për ta bërë! Dhe tani vjen tek unë i

lodhur dhe më thua se je njeri i falimentuar?! Kush të ka tunduar që ti ta mendosh një gjë të tillë? Mos ka ndodhur që ja ke vënë veshin fjalëve të djallit?! Kujtohu mirë se ai është mashtrues dhe gënjeshtar! Shikoje pak veten tënde: krahët e tu janë të fortë dhe plot muskuj, duart i ke plot kallo por të forta dhe gjithashtu këmbët e tua janë të fuqishme. Pavarësisht mundimeve që ke kaluar ti je rritë shumë dhe tani aftësitë e tua janë më të mëdha se ato që i kishe para se të bëje vullnesën time. Tani ti mund të bësh shumë gjëra që më përpara as që mund të ëndërroje ti bëje. Sigurisht, nuk e ke lëvizur gurin, por misioni i jot ishte që të pranoje për ta shtyrë e kështu të ushtroje besimin tënd në mua. Unë e di se ti nuk je i aftë ta shtysh gurin. Për këtë arsye dhe nuk ta kam kërkuar një gjë të tillë. Unë nuk jap kurrë peshë që të mund ti kalojnë aftësitë e secilit. Ti më je bindur! Ke qenë besnik ndaj meje dhe mbi të gjitha, përpara se ti besojë djallit, ti më je drejtuar mua. Të lumtë. Tani, biri im i dashur, unë do ta lëvizim gurin për ty”!

Të jetosh një fe, një besim me detyrën për të lëvizur nga vendi i tyre malet, por të ndërgjegjshëm që në fund të fundit është Zoti ai që i lëviz malet që kemi përpara.

Dhe kur gjithçka të duket se po shkon keq, ti “vazhdo të shtysh”!

Dhe kur të ulesh i lodhur dhe pa pikë forcë në trup ti “vazhdo të shtysh”!

Sepse kush do ti lëvizim pengesat...do të jetë Zoti për ty!